



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLICA KOSOVAS  
REPUBLIKA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odhajenje za Opštu Upravu  
Nr. i prot. 2241 Më 16-07-24  
Br. prot. Dt. 20  
RAHOVEC - ORAOVAC

# Informatë



JANAR - QERSHOR

7/16/2024

## Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL .....	3
Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars .....	3
Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor .....	4
Pagesat Direkte - Subvencionet 2024.....	5
Grantet .....	8
Qent Endacak: .....	11
Projektet e investimeve kapitale .....	11
Kanalet e kullimit .....	11
Incimi i procedurave tenderuese.....	11
Pastrimi i përrrenjëve .....	11
PËRFUNDIM .....	12

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Përmes politikave dhe strategjive tentojmë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas të resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

### Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitesh.

Aktivitetet të cilat kryhen vazhdimisht siq janë pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermer që dëshmon se janë prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt Janar, Shkurt dhe Mars etj.

Ndërsa aktivitetet më kryesore paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: **15 janar deri më 13 shkurt 2023**.
- Gjithësej kanë aplikuar **91** blegtorë, me gjithsej: **1,709,950** litra qumësht dhe **522** krerë të viçave për majmëri
- Kemi mbajtur takim me Agjensionin Pyjor, ku dhe ju kemi bartur kompetencat për stafin e Pylltarisë.
- E kemi përfunduar Cash planin për vitin 2024.
- Është nënshkruar kontrata "Furnizim me preparate për luftimin e insektit cikadia të hardhisë së rrushit"
- Është nënshkruar kontrata me Qendrën Grumbulluese "Agro Celina", në vitin 2024 e cila do të furnizojë bujqit me Fidane dhe inpute tjera për kulturën e trangullit "Kornishan" Përmes kësaj marrëveshje do të mbulohen: Fidanet cilësore të trangullit, Plehërimi dhe Riplehrimi (kristalorët), Pesticidet, Mulqerimi ( Folia e zezë), Sistemi i ujitjes pikë-pikë.



- Gjatë muajit janar për shkak të erës së fuqishme, kanë ndodhur disa dëme, kemi pranuar informata nga disa fermerë që iu janë shkaktuar dëme dhe të cilëve më pas iu kemi pranuar kërkesat e tyre dhe komisioni ka dalë në terren për verifikim të dëmeve.
- Poashtu gjatë muajit janar ne si Drejtori dhe si Komune e Rahovecit e kemi përmbyllur raportin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2023 duke proceduar edhe në Kuvendin e Komunës
- Veterinari i punësuar në DBPZHR, ka kryer vaksinimin e bagëtive të trasha dhe të imëta për të parandaluar sëmundjet infektive, gjatë këtij muaji janë vaksinuar 1915 krerë lopë dhe rreth 7500 dele.
- Nga 6 mars deri më 20 mars, ka qenë e hapur thirrja për aplikim: Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit. Gjithsej kanë aplikuar 495 fermerë Vreshtarë.



### Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor

- Është formuar komisioni për verifikimin e aplikacioneve për thirrjen : Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit, komisioni ka publikuar raportin dhe listën e **495** përfituesëve të preparatit.
- Poashtu është bërë rishpallja e thirrjes: Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit, e cila ka qenë e hapur nga data 24 maj deri më 3 qershor 2024. Komisioni ka formuar sërish raport dhe ka publikuar listën me **82** përftues. Përfituesit e këtij preparati janë njoftuar dhe janë furnizuar.
- Gjatë muajit muajit maj është hapur thirrja: Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL, afati i aplikimit ka qenë nga data: **02.05.2024** deri më **22.05.2024**. Gjithsej kemi pranuar

1134 aplikacione. Komisioni i ka verifikuar aplikacionet, është shpallur lista përfituese dhe fermerët përfitues janë duke e kryer participimin prej 20%.

- Nga data **31.05.2024** deri më **14.06.2024** ka qenë e hapur thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e festivaleve tradicionale dhe kulturore si: Festa e Vjeljes së Rrushit – 7 shtatori dhe Agrofesta për vitin 2024. Është formuar komisioni dhe është zgjedhur OJQ përfituese.

## Pagesat Direkte - Subvencionet 2024

Më **13 mars** është hapur aplikimi për pagesa direkte/subvencione për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. Për sektoret, të cilët do të mbështeten përmes Programit për Pagesa Direkte 2024, afati për aplikim ka qenë i hapur deri më **12 prill 2024**, mirëpo pas kërkesës tonë, është zgjatuar deri më **29 prill 2024**.

Ne si drejtori e BPZHR-së jemi angazhuar të mobilizohemi me zyret në Krushë të Madhe dhe Ratkoc ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyrat e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në këto dy qendra të mëdha poashtu kemi bërë kërkesë për hapjen e userave për zyrtarët të cilët kanë pranuar aplikacione të bujqëve.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2024 është **3,099** ku krahasuar me vitin 2023 kemi **20** aplikacione më pak.

Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna më pastaj përlllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

**Tabela 1.** Të dhënat e kulturave bujqësore të ndara me sektorë dhe të shprehura në sip/ha për të mbjellat si dhe në numër për bagëti, për të cilat kanë aplikuar fermerët e Komunës sonë.

Të dhënat e fermerëve		2022	2023	2024	Diferenca
Sektori I Lavërtarisë		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	Sip. në ha
1	Grurë	2,006.21	2,743.61	2520.53	-223.08
2	Misër	1,578.94	1,943.60	1875.96	-67.64
3	Elb	4.05	1.12	6.5	5.38
4	Tersher	122.04	80.01	99.9	19.89
5	Theker	0.00	0.00	1.72	1.72
Gjithsej		3,711.24	4,768.34	4,504.61	-263.73
Sektori I Vreshtarise		Sip ne ha	Sip ne ha	Sip në ha	
Lloji I kulturës					
2	Rrush	2,322.21	2,274.57	2,216.29	-58.28
3	Fidane të hardhisë	149,900.00	124,000.00	127,000.00	3,000.00
Sektori I Perimkultures		Sip në ha	Sip në ha	Sip në ha	
1	Speca	695.30	616.41	695.30	78.89
Spec (shume lloje)				132.00	
Kurtosk				247.85	
Sombork				315.45	

## Informatë | janar-qershor 2024

2	Domate	11.48	9.66	17.41	7.75
3	Qepë	149.76	186.78	235.47	48.69
4	Hudhër	25.56	20.37	14.66	-5.71
5	Patate	166.35	189.22	260.02	70.80
6	Tranguj	0.43	0.74	0.61	-0.13
7	Karota	7.65	7.14	6.38	-0.76
8	Rrepkë	0.00	0.49	0.00	-0.49
9	Brokuli	0.25	0.00	0.30	0.30
10	Fasule	0.46	1.90	2.70	0.80
11	Pangjar	0.00	0.00	0.00	0.00
12	Lakër	144.20	70.65	134.97	64.32
13	Lulelakër	10.82	10.23	8.06	-2.17
14	Presh	0.20	0.00	0.57	0.57
15	Spinaq	0.84	0.48	0.85	0.37
16	Marule	0.64	0.90	1.68	0.78
<b>Gjithsej</b>		<b>1,213.94</b>	<b>1,114.97</b>	<b>2,074.28</b>	<b>959.31</b>
<b>Kungullore</b>		<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	
1	Shalqinj	164.68	171.68	353.99	182.31
2	Pjepër	100.24	84.49	98.71	14.22
3	Kunguj	11.82	6.58	23.80	17.22
4	kungull I Gjelbert	302.84	160.41	242.77	82.36
<b>Gjithsej</b>		<b>579.58</b>	<b>423.16</b>	<b>719.27</b>	<b>296.11</b>
<b>Spektori I Pentarisë</b>		<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	
1	Dardhë	6.63	7.81	3.46	-4.35
2	Dredhëz	2.72	2.09	1.19	-0.90
3	Kumbull	54.86	62.65	49.92	-12.73
4	Mollë	8.96	10.26	8.70	-1.56
5	Arra	73.90	95.15	92.86	-2.29
6	Lajthi	10.77	9.22	9.52	0.30
7	Ftoj	4.17	3.86	3.86	0.00
8	Mjeder	0.53	0.00	0.00	0.00
9	Pjeshkë	2.69	3.27	2.96	-0.31
<b>Gjithsej</b>		<b>165.23</b>	<b>194.31</b>	<b>172.47</b>	<b>-21.84</b>
<b>Spektori I Blegtorisë dhe shpezetarisë</b>					
1	Bletë	4,245.00	4,793.00	5,276.00	483.00
2	Lopë	1,938.00	1,953.00	1,966.00	13.00
3	Dhi	248.00	167.00	150.00	-17.00
4	Dele	7,226.00	7,396.00	5,244.00	-2,152.00
5	Pula vojëse	59,100.00	60,260.00	52,000.00	-8,260.00
Nr.	Lloji I kulturës	<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	
1	<b>BMA</b>	<b>16.51</b>	<b>8.54</b>	<b>10.96</b>	<b>2.42</b>
<b>Perime ne Serra</b>					
1	Perime	24.26	27.21	28.77	1.56

Nga tabela e prezantuar me lartë mund të vërejm se këtë vit kemi rritje në sektorin e perimekulturës, konkretisht te kultura e **Specit, Shalqinit, Patates, Lakrës dhe Qepës**, ndërsa zbritje në sipërfaqet e mbjellura kemi te drithërat si: **Grurë dhe Misër**.

**Tabela 2. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2024/2023 të shprehura në Sipërfaqe**

VITET		2022	2023	2024	Diferenca
Sektorët		Sip ne ha			Sip. Ha
Sektori i Lavertarise	Dritherat	3,711.24	<b>4,768.34</b>	<b>4,504.61</b>	-263.73
	Grurë - KG				0.00
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	2,322.21	<b>2,274.57</b>	<b>2,216.29</b>	-58.28
	Fidane të hardhisë	149,900.00	<b>124,000.00</b>	<b>127,000.00</b>	3,000.00
Sektori i Perimkulturës	Perime	1,213.94	<b>1,114.97</b>	<b>2,074.28</b>	959.31
	Kungullore	579.58	<b>423.16</b>	<b>719.27</b>	296.11
Sektori i Pentarisë		164.30	<b>194.31</b>	<b>172.47</b>	-21.84
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	4,245.00	<b>4,793.00</b>	<b>5,276.00</b>	483.00
	Lopë	1,938.00	<b>1,953.00</b>	<b>1,966.00</b>	13.00
	Dhi	248.00	<b>167.00</b>	<b>150.00</b>	-17.00
	Dele	7,226.00	<b>7,396.00</b>	<b>5,244.00</b>	-2,152.00
	Pula vojëse	59,100.00	<b>60,260.00</b>	<b>52,000.00</b>	-8,260.00
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA		16.51	<b>8.54</b>	<b>10.96</b>	2.42
Perime ne Serra		24.26	<b>27.21</b>	<b>28.77</b>	1.56

Në këtë tabelë janë paraqitur të dhëna e të mbjellurave në mes vitit 2024 dhe vitit 2023 si dhe ndryshimi mes këtij viti dhe vitit paraprak. Ku mund të themi se në kulturat lavërtare – Drithëra në këtë vit kemi për 263 ha më pak sipërfaqe të të mbjellave.

Poashtu është lajm i mirë se kemi rritje të të mbjellurat me perime për 1,255 ha

**Tabela 3. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2024/2023 të shprehura në EURO**

VITET		2022	2023	2024	Diferenca
Sektorët		Vlera në €			Vlera në €
Sektori i Lavertarise	Dritherat	1,228,287.38 €	1,490,052.36 €	1,405,488.44 €	-84,563.92 €
	Grurë - KG				0.00 €
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	2,439,409.22 €	2,397,396.78 €	2,446,784.16 €	49,387.38 €
	Verë	290,995.06 €	294,518.32 €	181,955.66 €	-112,562.66 €
	Fidane të hardhisë	22,485.00 €	18,600.00 €	19,050.00 €	450.00 €
Sektori i Perimkulturës	Perime	665,213.34 €	636,805.38 €	1,258,835.70 €	622,030.32 €
	Kungullore	206,394.12 €	175,984.14 €	305,176.08 €	129,191.94 €
Sektori i Pentarisë		73,935.00 €	97,932.24 €	86,924.88 €	-11,007.36 €
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	84,300.00 €	95,860.00 €	105,520.00 €	9,660.00 €
	Buallica		0.00 €	900.00 €	
	Lopë	173,790.00 €	175,770.00 €	176,940.00 €	1,170.00 €
	Mëshqerra		0.00 €	7,550.00 €	
	Dhi	6,200.00 €	4,175.00 €	4,500.00 €	325.00 €
	Dele	173,790.00 €	184,900.00 €	131,100.00 €	-53,800.00 €
	Pula vojëse	6,200.00 €	27,719.60 €	26,000.00 €	-1,719.60 €
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA		7,429.50 €	4,304.16 €	5,523.84 €	1,219.68 €
Perime ne Serra Te gjitha llojet		20,621.00 €	24,597.84 €	26,008.08 €	1,410.24 €
Gjithsej		5,399,049.62 €	5,628,615.82 €	6,188,256.84 €	559,641.02 €

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 3 ku janë paraqitur edhe vlerat monetare duke u bazuar në Programin e Pagesave Direkte të prezantuar nga MBPZHR, vërejmë se në total fermerët e komunës së Rahovecit kanë përfutur rreth **6 milion e 190 mijë Euro** që do të thotë se krahasuar me vitin 2023 këtë vit kemi rritje për rreth **560 mijë Euro**. Këtë rritje e kanë ndikuar kryesisht rritja e sipërfaqeve me perime si dhe rritja e vlerës së përkrahjes nga MBPZHR për disa kultura në këtë sektor.

Një ndryshim negativ të theksuar për rreth **110 mijë Euro** e vërejmë te prodhimi i litrave të verës, ku edhe përkundër dyfishimit të përkrahjes nga MBPZHR nga **0,04€/l në 0,08€/l**, kemi më pak të hyra për vertarët tanë pasi që nga 7 milion e 300 mijë litra të prodhuara në vitin 2023, këtë vit kemi rreth 2 milion e 100 mijë litra të deklaruar, me një diferenc negative me mbi 5 milion litër.

## Grantet - MBPZHR

Ashtu sikur çdo vit edhe në vitin e kaluar MBPZHR ka hapur thirrje për aplikim të fermerëve në skemën e granteve. Përmes konsulencës së angazhuar nga Komuna e Rahovecit kemi dorëzuar në Ministri 54 projekte në sektor të ndryshëm. Thirrja ka qenë e hapur nga data 31.10.2023 deri më 14.12.2023.

Nga 54 aplikime deri më tani 21 janë aprovuar dhe janë nënshkruar kontratat, 18 aplikues janë në listë të pritjes dhe 9 aplikacione janë refuzuar. Jemi në pritje të rezultateve edhe për masën 3 në sektorin e përpunimit ku gjithsej kemi 6 aplikues. Vlera e përfutur deri më tani është **1 milion e 160 mijë Euro**, ndërsa jemi në pritje të aprovimit të listës rezervë, ku janë 18 aplikacione në vlerë **923 mijë Euro**.

Tabela 4. Aplikuesit në Ministrinë e Bujqësisë në skemën e Granteve

Nr	Nr. NIF-it	Sektori aplikimit	Vendi	Vlera e aplikimit	
<b>MASA 1</b>					
<b>1.1 Pemë Drufrutore</b>					
1	1032941	Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	
<b>1.1 a) Arra, Lajthia dhe Gështenja</b>					
2	1101645	Infrastruktura - Arra	Vrajakë	50,000.00 €	
3	1124315	Arra	Çifllak	50,000.00 €	
<b>1.2 Pemë Manore</b>					
<b>1.3 Sektori i perimve dhe serrave, përfshirë serrat për fidane</b>					
4	1039345	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Ankesa aprovuar
5	1123859	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Kalon
6	1038579	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Rezerv
7	1084860	Sere	Krushë e Madhe	43,455.00 €	Rezerv
8	1003659	Sere	Radoste	50,000.00 €	Ankesa refuzuar
9	1123820	Sere	Xërxë	50,000.00 €	Kalon
10	1123985	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Kalon
11	1055290	Sere	Dejnë	50,000.00 €	Ankesa refuzuar
12	1003797	Sere	Rahovec	50,000.00 €	Rezerv



## Informatë | janar-qershor 2024

13	1113348	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Kalon
14	1094560	Sere	Krushë e Madhe	50,000.00 €	Rezerv
15	1124159	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Rezerv
16	1098476	Sere	Mrasor	50,000.00 €	Rezerv
17	1014040	Sere	Bellacërkë	50,000.00 €	Ka Refuzu me dorezu ankesen
18	1051909	Sere	Bellacërkë	50,000.00 €	Rezerv
19	1003714	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Rezerv
20	1106202	Sere	Krushë e Madhe	50,000.00 €	Rezerv
21	1074584	Sere	Dobidol	50,000.00 €	Rezerv
22	1021035	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Rezerv
23	1124303	Sere	Radoste	50,000.00 €	Rezerv
24	1040339	Sere	Çifllak	50,000.00 €	Ka Refuzu me dorezu ankesen
25	1036550	Sere	Krushë e madhe	50,000.00 €	Rezerv
<b>1.4 Depo per ruajtjen e pemeve dhe perimeve</b>					
<b>1.5 Prodhimi i mishit / rritja e vjçave</b>					
26	1084544	Mekanizem	Vrajakë	50,000.00 €	Rezerv
<b>1.6 Prodhimi i mishit / rritja e derrave</b>					
<b>1.7 Prodhimi i qumeshtit / lopë</b>					
27	1028444	Shtalle	Çifllak	100,000.00 €	Rezerv
28	1062070	Lope	Radoste	50,000.00 €	Kalon
29	1009516	Mekanizem	Krushë e Madhe	100,000.00 €	Rezerv
30	1026614	Lope	Krushë e Madhe	30,000.00 €	Rezerv
31	1003501	Lope + Mekanizem	Bratotin	100,000.00 €	Kalon
32	1022395	Lope	Opterushë	50,000.00 €	Kalon
33	1003247	Lope	Krushë e Madhe	50,000.00 €	Kalon
<b>1.8 Prodhimi i qumeshtit / dele dhe dhi</b>					
<b>1.10 Prodhimi i rrrushit</b>					
34	1094988	Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
35	1031713	Vreshte	Rahovec	40,000.00 €	Kalon
36	1003085	Infr.+ Paisje	Rahovec	30,000.00 €	Kalon
37	1038158	Vreshte	Rahovec	50,000.00 €	Ankesa refuzuar
38	1030969	Vreshte + Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
39	1012347	Mekanizem	Rahovec	100,000.00 €	Ankesa refuzuar
40	1009897	Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
41	1003859	Vreshte + Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
42	1005948	Vreshte	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
43	1024192	Vreshte	Drenoc	30,000.00 €	Kalon

## Informatë | janar-qershor 2024

44	1124233	Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
45	1032164	Vresht	Rahovec	20,600.00 €	Kalon
46	1060809	Sistem ujitje	Rahovec	40,000.00 €	Kalon
47	1101236	Mekanizem	Rahovec	50,000.00 €	Refuzim
<b>1.11 Prodhimi i vezëvet</b>					
48	1001007	Renovim + Paisje	Çifllak	100,000.00 €	Kalon
<b>MASA 7</b>					
<b>7.1 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jodrusore të pyllit PPJD</b>					
<b>7.2 Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural</b>					
<b>7.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare</b>					
49	1022481	Paisje - raki dhe vere	Rahovec	50,000.00 €	2 NIF-a
50	1061395	Depo perime	Krushë e Madhe	50,000.00 €	Refuzim
51	1124321	Depo - raki	Rahovec	50,000.00 €	Kalon
<b>7.4 Prodhim i mjaltit</b>					
<b>7.5 Aktivitete jo-bujqësore në zona rurale</b>					
<b>MASA 3</b>					
<b>3.2 Përpunimi i mishit</b>					
<b>3.4 Përpunimi i pemëve dhe perimeve</b>					
52	1024460	Perime - paisje	Krushë e Madhe	400,000.00 €	
<b>3.5 Përpunimi i verës</b>					
53	1112280	Paisje	Rahovec	400,000.00 €	
54	1025139	Paisje	Rahovec	320,000.00 €	

### *Lista totale e projekteve*

Kalon	21 projekte
Në rregull me pikë (Rezervë - Mungesë e Buxhetit)	18 projekte
Refuzim	9 projekte
Në pritje të rezultateve	6 projekte

## Qent Endacak:

Ka vazhduar aksioni për trajtimin e qenve endacak gjatë gjithë kësaj periudhe raportuese, në disa lokacione të komunës sonë, ku shpresojmë që deri në kohën e ardhjes së mërgimtarëve të kemi gjendje më të mirë në terren. Poashtu jemi duke bashkëpunuar me përfaqësues të KFOR-it LMT lidhur me përkrahje për trajtim të qenve endacak nga CIMIC-u gjerman, ku jemi në pritje të një përgjigje të një projekti që kemi aplikuar.

## Projektet e investimeve kapitale

### Kanalet e kullimit

**Kanali i Kullimit në Ratkoc** – Kanë vazhduar punimet, në disa pozicione. Është instaluar një segment i kanalizimit në gjatësi prej 100 m si dhe ka filluar pastrimi në pjesën nën hekurudhë, ku gjatë kësaj periudhe është duke u ndërtuar kanali kryesor si dhe ndërtimi i urës për fermer.

**Kanali i Kullimit nga Shtavica deri ne Fortese**- Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e kanalit, aktualisht është duke u betonuar baza e kanalit si dhe ndërtimi i skarpateve. Poashtu është duke u përgatitur edhe ndërtimi i urës së fundit te vendi i quajtur "Mulliri Hoxha"

**Kanali i Kullimit në Çifllak**- Ka përfunduar segmenti në lagjen Thaqi përball hekurudhës, janë duke vazhduar punimet dhe brenda kësaj periudhe do të fillojë ndërtimi i urës në mes te fshatit.

**Kanali i Kullimit Fortesë – Celinë** – janë duke vazhduar punimet ne instalimin e gypave fi: 1000 ne segmentin kryesor të këtij projekti. Tani është lidhur kontrata dhe kanë filluar punimet në fazën e dytë të këtij projekti i cili ka për qëllim shkarkimin e ujrave të grumbulluara në drejtim të lumit Drini i Bardhë.

### Incimi i procedurave tenderuese

Në këtë periudhë raportuese janë iniciuar procedurat tenderuese për projektet e reja në kuadër të drejtorisë si:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e Rrugëve Fushore
- Ndërtimi i urave në Komunën e Rahovecit
- Ndërtimi i serrave për fermerë me participim 80%-20%

### Pastrimi i përrenjëve

Pastrimi i kanaleve dhe përrenjëve ka pasur fokusin kryesor në këtë pjesë të parë të vitit. Kemi intervenuar në shumë lokacione si: Rahovec (rimnik), Nagafc, Zoqisht, Kramovik, Xërxë. Aktualisht është duke u pastruar përroi në dalje të fshatit Ratkoc, konkretisht te pompa e derivateve DINA-H i cili është përfunduar. Poashtu sipas kërkesës se banoreve te fshatit Gexhë jemi duke pastruar segmentin ne hyrje të fshatit në mes të fshatit Malësi e Vogel deri më tani i patrajtuar ndonjë herë.

## PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermerë në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre.

Zyrtarët kanë qenë të gatshëm për çdo vlerësim dëmi me të cilët fermerët e komunës sonë ballafaqohen, ata dalin në terren në qdo fatkeqësi natyrore që ndodh dhe dëmton kulturat bujqësore.

16.7.2024

Rahovec

